



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



01 Nr. 400-39539 dt. 01.08 2022

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 20.07.2022, ora 10:00.
Mbledhjen ë kryesoi: Milaim Hajdari- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe Drejtor të Drejtorive Komunale.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt.17.06.2022
2. Raporti Financiar Janar-Qershor 2022.
3. Propozim vendim për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik (për 99 vite)
4. Informim i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
5. Propozim vendim për ndërrimin e statutit të Institucionit Arsimor Publik Parauniversitar- Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale (SHMLP) " Fehmi Lladrovci" të kaloj në Institucion për Arsim dhe Aftësim Profesional (IAAP)
6. Propozim vendim për ndarjen e mjeteve.
7. Propozim vendim për rialokimin e mjeteve financiare nga mbetjet e projekteve kapitale brenda kategorisë.
8. Draft Rregullore për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në Komunën e Drenasit.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës theksoi se kemi edhe një pikë shtesë për rendin e ditës: 1. Propozim vendim bartja e mjeteve financiare nga kategoria rezerva. Pasi që nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës me pikën që u cek, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan në mënyrë unanime të gjithë anëtarët e KPF-së.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur me dt. 17.06.2022**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me:
07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2.Raporti Financiar Janar-Qershor 2022.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime me vota unanime e rekomanduan për mbledhjen e kuvendit këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim vendim për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik (për 99 vite)**

Drejtori për Gjeoderi, Kadaster dhe Pronë Ruzhdi Lestrani, lista e veçantë është miratuar vitin e kaluar që e kanë si obligim ligjor për pronat të cilat do të lëshohen në shfrytëzim afatgjatë deri 99 vite, sqaroj se të parcelat 10/32 për 2 në listë të veçante kanë qenë tjera është bërë bashkimi i saj edhe është ndarë ashtu siç e kërkon ligji, dhe është një bashkim i parcelave është bërë në Komoran parcelat në listë të veçantë i keni 1për 8, 1për13 për arsyeje se është bërë një ndërtim në të dy parcelat dhe u dashtë me i bo bashkimin e dy parcelave tash është në listë 19/87. Sqaroj se ne listë të veçante janë tjera numra të parcelës e në propozim paraprak që e keni para vetes janë tjera parcela, janë në listë të veçante por është bërë bashkim i parcelave ashtu siç e kërkon ligji.

Pasi që nuk pati diskutime tjera, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me:
05 vota (Për), kundër nuk pati, 1 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën ekatër të rendit të ditës: **4.nformim i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime me vota unanime e rekomanduan për mbledhjen e kuvendit këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5.Propozim vendim për ndërrimin e statutit të Institucionit Arsimit Publik Parauniversitar- Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale (SHMLP) " Fehmi Lladrovci" të kaloj në Institucion për Arsim dhe Aftësim Profesional (IAAP)**

Drejtori i Arsimit, Muhamet Gjoka- ky propozim vendim vjen pas koordinimit me divizionin e arsimit profesional në kuadër të Ministrisë të Arsimit, ne i kemi edhe dy profile të mjekësisë Farmaci dhe Infermieri dhe në mënyrë që të kemi mundësi dhe

për profile tjera varësisht prej nevojave të tregut, dmth ky ndërrim i statutit na mundëson që të kemi mundësi që të bëjmë kërkesën edhe për profile të reja dhe në procedurë në bazë të ligjit për arsim profesional të miratohen në procedurë të shpejt kemi mundësi të hapim edhe profile të reja. Siç e dini ka qenë shkollë e mesme teknike, në shkollë teknike janë profilet e kufizuara, në përgjithësi në Kosovë shkollat profesionale janë duke kalu në këtë statut të institucionit të aftësimit dhe profilit institucional është duke u bërë edhe harmonizimi i korrektulave.

Arbër Halilaj, përveç si kërkesës ligjore unë jam për që arsimit profesional dhe arsimit i mesëm të ndërlihet me kërkesat e tregut të punës, e përkrahi këtë ndryshim.

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me:
07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Propozim vendim për ndarjen e mjeteve.**

Drejtori i Shëndetësisë- Arsim Haxhiu, është propozim vendim për ndarjen e një shumë të mjeteve nga kategoria e subvencioneve dhe transfere në Drejtorinë e shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale për arritjen dhe realizimin e projektit marrëveshjes mes ministrisë së jashtme gjermane dhe Komunës së Drenasit, diku 8 mijë euro është shuma që ne marrim pjesë ndërsa 35 mijë është krejt projekti, 7 mijë ata ku përfitues janë 10 familjet të skemës sociale start-up si ndihmës ku ata të pavarësohen ndërsa pjesa tjetër do të jetë investime në objektin e HANDIKOS-it rreth krijimit të kushteve më të mira.

Florentina Elezi Veliu, a dihet paraprakisht se cilat familje kanë me i përfitu apo qysh kane me u përzgjedh?

Drejtori i Shëndetësisë- Arsim Haxhiu, do të fillojmë procedurat sipas marrëveshjes do ta bejmë përzgjedhjen e tyre.

Florentina Elezi Veliu, para se me e pru këtë propozim vendim a keni pas ndonjë takim me HANDIKOS-in për me ditë paraprakisht se si është mendimi i tyre sepse kemi pas takime me ata dhe me të vërtetë e kane objektin e tmerrshëm dhe kanë nevojë për një objekt te ri e me këtë propozim a janë pajtuar ata për rinovim të objektit.

Drejtori i Shëndetësisë- Arsim Haxhiu, janë pajtuar sigurisht që do të jetë një bashkëpunim mes drejtorive, pjesa sociale është e jona natyrisht.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne i mbështesim dhe përkrahim çdo OJQ që kemi mundësi edhe që kemi kapacitet. Sa i përket propozim vendimit, sa i përket propozim vendimit nuk i zgjedhim ne i zgjedh komisioni ku janë të përcaktuara kushtet dhe kriteret për përfituesin.

Pasi që nuk pati diskutime tjera, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me:
07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Propozim vendim për rialokimin e mjeteve financiare nga mbetjet e projekteve kapitale brenda kategorisë.**

Arbër Halilaj, pse kemi mungesë të mjeteve buxhetore për me i realizu këto projekte kapitale kërkoj sqarim.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, çdo mbetje kur të përfundon një projekt ato që mbesim i riallokojmë.

Pasi që nuk pati diskutime tjera, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me:
06 vota (**Për**), kundër nuk pati, 1 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Draft Rregullore për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në Komunën e Drenasit.**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ligji i ri e përcakton rregullimin e bashkëpunimin e me Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në Komunën e Drenasit nga 34 lokacione sa i kemi ne kemi me i pas 25 dhe koordinatore të fshatrave ose përfaqësuesit e fshatrave nuk kane me qenë krejt përfaqësues por kanë me qenë 25 dhe do të behet ndarja sa fshatra kane me e pas një përfaqësues dhe kemi me pas mundësin e pagesës se koordinatoreve të fshatrave.

Pasi që nuk pati diskutime tjera, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me:
07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: **9. Propozim vendim bartja e mjeteve financiare nga kategoria rezerva**


Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, këtë propozim vendim e kemi sjelle tani për arsye se ne muajin gusht nuk ka mbledhje të kuvendit, propozim vendim bartja e mjeteve financiare nga kategoria rezerva, neve na dërgojnë në kategori rezerva shpesh herë kur nuk arrijmë me e zhvillu një projekt ose kur mjetet janë të caktuara për diçka tjetër.

Pasi që nuk pati diskutime tjera, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me:
07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës: **10. Të ndryshme.**

Pasi që nuk pati diskutime tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur mbledhjen e KPF-së.
Mbledhja përfundoj rreth orës: 10:31 min.


Procesmbajtëse:



Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Milaim Hajdari